

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ditë e zezë për Kosovën/ Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi shpallen fajtorë për krime lufte
ADRESA	https://piranjat.al/kosova/dite-e-zeze-per-kosoven-thaci-veseli-selimi-dhe-krasniqi-shpallen-fajtores-i104402
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 10:23:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 10:12:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	eed9cc8be61179d5ee715f7031ea777f7c5222e949edab5cc72c48170fe61708
TEKSTI	45b4e1d4f2a44d705e11ae11ddc73cdc074c538102a344ba5f21161f1c4396d0
PAMJA	e7db5dcb8c75e4f8b31b8b1cee9ad2343b0a081f1454e3c21ef4b9f330dba756

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3423bb3a229754d7dbcf7eec9636ed43d3190518815504539ee16dd83073ec23
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1f56947d1ce9865195ccff7ffa5c5fdb522467bff0934ba4720654b865868030
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3423bb3a229754d7dbcf7eec9636ed43d3190518815504539ee16dd83073ec23>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: Selimi dhe Krasniqi ■ krerëve të UÇK nga Haga: ■ reagon vajza e ■ Krasniqi, ka reaguar pas vendimit të Dhomave të ■ e UÇK-së, ■ reagon kryeministri Edi Rama. ■ gjykyes në ■ Selimi është shpallur ■ vite burg

KOSOVA

Ditë e zezë për Kosovën/ Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi shpallen fajtorë për krime lufte

Piranjat Përditësimi i fundit 16 Shtator 2026, 12:12



Ish-krerët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, dëgjuan sot vendimin në seancën e dhënies së aktgjyqimit të shkallës së parë të Dhomave të Specializuara në Hagë.

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është shpallur fajtor për krime lufte dhe është dënuar me 25 vjet burgim nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Po ashtu edhe Jakup Krasniqi e Kadri Veseli. Ndersa, Rexhep Selimi është dënuar me 18 vjet burgim, qe e konvertuar me vitet e paraburgimit ai do kryejë 13 vite burg.

Trupi gjykyes e shpalli Thaçinin penalisht përgjegjës për krime që përfshijnë vrasje, torturë, trajtim mizor dhe ndalim të paligjshëm, të kryera gjatë luftës në Kosovë.

Trupi gjykyes konstatoi se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë penalisht përgjegjës për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme.

Trupi gjykyes tha se përgjegjësia e katër të akuzuarve është individuale, por konstatoi se ata vepruan së bashku dhe arritën marrëveshje për një qëllim të përbashkët kriminal.

Sipas gjykatësit Smith, ata ngritën bashkërisht objekte ndalimi, u caktuan personave të tjerë role dhe pozita për realizimin e këtij qëllimi dhe lëshuan komunikata përmes të cilave përhapnin qëndrimet dhe politikën e tyre.

Trupi gjykyes konstatoi gjithashtu se të akuzuarit siguruan pandëshkueshmëri të plotë për kryesit e krimeve.

Trupi gjykyes konstatoi se Hashim Thaçi dhe një kontribut thelbësor në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal.

Sipas gjykatësit Charles Smith, Thaçi ishte anëtar kyç në zbatimin e këtij qëllimi.

Ai dhe të akuzuarit e tjerë emëruan persona besnikë në pozita të ndryshme për të ruajtur kontrollin brenda UÇK-së gjatë gjithë periudhës përkatëse, shtoi Smith.

Sipas tij, shumë prej këtyre personave kryen krime ose ishin në dijeni të kryerjes së tyre.

Trupi gjykyes konstatoi se Hashim Thaçi kishte dijeni për një numër të konsiderueshëm krimesh të kryera kundër personave të konsideruar kundërshtarë.

Sipas gjykatësit Smith, pavarësisht kësaj dijenieje, Thaçi nuk ndërmori hapa për parandalimin apo ndëshkimin e krimeve.

Trupi gjykyes konstatoi se, përkundrazi, ai mori pjesë personalisht në krime.

Smith tha gjithashtu se Thaçi përhapri ose ndihmoi në përhapjen e informacioneve të rreme për krimet, duke kontribuar në politikën e pandëshkueshmërisë.

Trupi gjykyes konstatoi se Kadri Veseli dhe kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal dhe ishte anëtar kyç në realizimin e tij.

Trupi gjyqësor konstaton se Kadri Veseli dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal dhe ishte një nga anëtarët kyç në realizimin e tij.

Sipas gjykatësit Charles Smith, Veseli veproi së bashku me të akuzuarit e tjerë në zbatimin e këtij qëllimi.

Trupi gjyqësor konstaton se Kadri Veseli mori pjesë në kryerjen e krimeve dhe inkurajoi kryerjen e tyre.

Sipas gjykatësit Charles Smith, Veseli dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal dhe ishte një nga anëtarët kyç në realizimin e tij.

Trupi gjyqësor konstaton se Rexhep Selimi inkurajoi dhe mori pjesë në kryerjen e krimeve në mënyra të ndryshme.

Sipas gjykatësit Charles Smith, Selimi mori pjesë edhe në arrestimin e 13 personave në Qirez.

Trupi gjyqësor konstaton se Jakup Krasniqi dha kontribut thelbësor në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal dhe ishte anëtar kyç në zbatimin e politikës së shënjestrimit të personave të konsideruar kundërshtarë.

Sipas gjykatësit Charles Smith, përmes publikimit të komunikatave, deklaratave politike dhe urdhreve, Krasniqi inkurajoi kryerjen e krimeve kundër personave të konsideruar kundërshtarë.

Trupi gjyqësor konstaton se krimet e kryera ishin të rënda dhe të përhapura gjerësisht, duke përfshirë 14 komuna të Kosovës dhe dy rrethe në veri të Shqipërisë.

Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 16 Shtator12:13

[“Vendim i papranueshëm dhe i padrejtë”/ Haradinaj pas dënimit të ish- krerëve të UÇK nga Haga: Beteja për drejtësi duhet të vazhdojë! Do t’i mundim armiqët të bashkuar](#)

Kryetari i Aleancës, Ramush Haradinaj, ka bërë thirrje për qetësi pas vendimit dënues të Gjykatës Speciale, duke thënë...

KOSOVA 16 Shtator12:01

[Babai iu dënua nga Haga me 25 vite burg, reagon vajza e Jakup Krasniqit: Krenaria dhe e vërteta ngelen](#)

Vajza e Jakup Krasniqit, Gresë Krasniqi, ka reaguar pas vendimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, përme...

KOSOVA 16 Shtator11:45

[Rexhep Selimi shpallet fajtor nga trupi gjyqësor në Hagë, dënohet me 13 vite burg](#)

Pas më shumë se pesë vitesh nga arrestimi i tyre, Rexhep Selimi është shpallur fajtor nga trupi gjyqësor të Dhomave të Speci...

KOSOVA 16 Shtator11:43

[Kadri Veseli dënohet me 18 vite burg](#)

Kadri Veseli është dënuar me 18 vjet burgim nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Trupi gjyqësor e shpalli Veselin fajtor për krim...

KOSOVA 16 Shtator11:39

[Jakup Krasniqi dënohet me 25 vjet burg nga gjykata e Hagës](#)

Gjykata në Hagë shpalli fajtor Jakup Krasniqin për disa nga akuzat për krime lufte, ndërsa e shpalli të pafajshëm për ...

KOSOVA 16 Shtator11:32

[Dënohet me 25 vite burg Hashim Thaçi](#)

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është shpallur fajtor për krime lufte dhe është dënuar me 25 vjet burgim nga...

KOSOVA 16 Shtator11:27

[Trupi gjyqësor: Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e krimeve. Selimi, rol në arrestimin e 13 deputetëve](#)

Trupi gjyqësor në Gjykatën e Hagës konstaton se Kadri Veseli dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët krimina...

KOSOVA 16 Shtator11:23

[Katërsheja e UÇK-së në Hagë/ “Heronj kombëtarë në Kosovë”, mediat botërore raportojnë për aktgjykimin final](#)

Mediat e mëdha ndërkombëtare po i kushtojnë vëmendje shpalljes së aktgjykimit ndaj ish-krerëve të Ushtrisë & Ccedil...

KOSOVA 16 Shtator11:22

[“Thaçi mori pjesë personalisht në krime”, Gjykata Speciale: Dha kontribut në qëllimin kriminal të UÇK!](#)

Gjykata Speciale ka konstatuar se Hashim Thaçi ka patur kontribut të qenësishëm në atë që konsiderohet si plan ...

KOSOVA 16 Shtator11:21

[Në pritje të lajmit nga Haga, nëna e Thaçit nuk e di se sot vendoset për djalin e saj, kushëriri i ish-presidentit: Nëse dënohet, nuk do t’ia tregojmë](#)

Në Burojë, vendlindjen e Hashim Thaçit, familjarët e ish-presidentit po e presin me ankth vendimin e Gjykatës Speciale në Hag&...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 15 Shtator

[Takimi pikant zgjat shumë dhe përfundon si mos ...](#)

Një takim seksual tepër i gjatë, një vjedhje parash, një debat midis një eskorte dhe klientit të saj, dhe në fund një keum...

AKTUALITET 15 Shtator

[Rrëfëhet 34-vjeçarja: Daja i Zegjine Caushit më...](#)

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak ditë më parë në Roskovec, ku Bledar Bakaj shkoi në shtëpinë e ish-bashkë...

Piranjat News AKTUALITET 15 Shtator

[VIDEO/ "Ku ka qiell e tokë, aty jam unë"/ Lulzi...](#)


"Piranjat News" kanë zbuluar se Lulzim Caka fshihej me dy identitete, duke përdorur emrin e rremë "Pepe". Ai përdo...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.